



Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri

*Të dhëna mbi periudhën kohore
2016-2018*



Drejtor botimi: ELSA DHULI, PhD

Kontribues teknik të botimit:

INSTAT: Majlinda Nesturi, Ledia Thomo, Olta Caca, Anisa Omuri, Dardan Bela MIMOZA Dushkaj, Anila Kasneci, Albana Berbiu, Blerta Muja, Eriona Dhamo

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve: Erik Gjermeni

UNICEF në Shqipëri: Elda Hallkaj

Design: Grid Cartels

© Copyright INSTAT 2020

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1

Tiranë, Kodi Postar 1017

Tel: + 355 4 2233358 / 2233356

Fax: +355 4 2222 411

e-mail: info@instat.gov.al www.instat.gov.al



Dokumenti është hartuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT) me mbështetjen teknike të UNICEF në Shqipëri, ofruar përmes Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve. Kjo ndërmarrje është realizuar në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas” (LNB), financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.



**Treguesit e Mirëqenies
së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe
të Rinjve në Shqipëri**

*Të dhëna mbi periudhën kohore
2016-2018*

Përmbajtja

Hyrje	5
Kapitulli 1: Tregues të përgjithshëm	6
Kapitulli 2: Tregues të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm	13
Shtojca	17

HYRJE

Ky botim përbën risi, pasi përmbledh në një material të vetëm 83 tregues me fokus fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë në Shqipëri. Pjesa më e madhe e treguesve janë përpunuar dhe raportuar për herë të parë përmes këtij botimi. Për formulimin e treguesve janë marrë për referencë botimet ndërkombëtare të fushës. Burimi i të dhënave është një kombinim i raportimeve administrative të institucioneve shtetërore, dhe anketave të kryera nga INSTAT.

Botimi është ndërtuar në disa kapituj sipas fokusit:

1 Kapitulli i Parë (1) pasqyron tregues të fushave të ndryshme me të dhëna krahasuese për periudhën kohore 2016 – 2018. Përtej paraqitjes grafike të trendeve ndër vite, kapitulli, paraqet shpjegimin e treguesve dhe burimin përkatës për çdo të dhënë.

2 Kapitulli i Dytë (2) hartëzon të gjithë treguesit e mundshëm me fokus fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Të dhënat pasqyrojnë informacionin më të fundit kohor, pasi qëllimi është të evidentohet mbi të gjitha situata e raportueshmërisë së treguesve.

3 Shtojca e botimit pasqyron vlera absolute të treguesve, si edhe, në disa raste, të dhëna më të zgjeruara për tregues specifikë.


Ky botim përfaqëson pikënisjen e një rrugëtimi të gjatë, i cili ka për qëllim përmirësimin e të dhënave zyrtare për fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri. Në kuadrin e zbatimit të kornizës aktuale rregullatore, INSTAT, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, synon ta përditësojë listën e treguesve dhe të dhënat korresponduese në mënyrë periodike – një vjeçare. Kjo nën kupton ndërveprim të vazhdueshëm mes INSTAT dhe institucioneve raportuese përgjegjëse, për të garantuar cilësinë e të dhënave dhe rregullsinë e raportimit të tyre.

Pasurimi i listës ekzistuese me tregues të tjerë, përfaqësues të një spektri të gjerë të fushave të mirëqenies së fëmijëve, si dhe sigurimi i të dhënave të përditësuara për secilin prej tregueve, synon të nxisë më tej përdorimin e tyre në funksion të vendim-marrjes efektive për interesin më të mirë të fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri. Përdoruesit e të dhënave mbi treguesit e mirëqenies së fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve pritët të jenë institucionet shtetërore, në rolin e tyre të planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit të masave, planeve e reformave me qendër fëmijët dhe të rinjtë. Përdorues të tjerë të të dhënave mendohet të jenë institucionet e pavarura, organizmat ndërkombëtarë, organizatat lokale jo-shtetërore, individë e akademikë që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve. Për më tepër, publikimi i treguesve në fjalë do të lehtësojë krahasueshmërinë e përmbushjes së të drejtave të fëmijëve edhe me vendet e tjera, të rajonit dhe me gjerë.

1. Tregues të përgjithshëm


Popullsia

Fëmijë, adoleshentë dhe të rinj në raport me popullatën e përgjithshme




Shpjegimi: Raportet e llogaritura mbështeten në popullsinë e datës 1 Janar të vitit respektiv
Burimi: INSTAT

Treguesi bruto i lindshmërisë




Shpjegimi: Raporti i numrit të lindjeve të gjalla me popullsinë mesatare për 1,000 banorë të të njëjtit vit
Burimi: INSTAT

Raporti gjinor në lindje



Shpjegimi: Raporti gjinor në lindje i meshkujve për 100 femra, mbi totalin e lindjeve të gjalla gjatë vitit
Burimi: INSTAT

Lindshmëria e femrave nën 20 vjeç



Shpjegimi: Përqindja lindjeve të femrave nën 20 vjeç në raport me lindjet gjithsej gjatë vitit
Burimi: Drejtoria e Përgjithsme e Gjendjes Civile / INSTAT


Jetëgjatësia mesatare në lindje (0-1 vjeç)

2016		2017		2018	
Mashkull	Femër	Mashkull	Femër	Mashkull	Femër
77	80.1	77.1	80	77.4	80.5

Shpjegimi: Jetëgjatësia mesatare në lindje është numri mesatar i viteve që një i porsalindur sot, pritet të jetojë nëse normat aktuale të vdekshmërisë vazhdojnë të aplikohen
Burimi: Agregat-INSTAT


Shëndetësia

Shkalla e abortit, sipas grupmoshës




Shpjegimi: Numri i aborteve të ndërprera gjatë vitit për 1,000 popullatë të moshës respektive të femrave, të raportuara nga institucionet shëndetësore
Burimi: Instituti i Shëndetit Publik / INSTAT

Raporti i abortit për 1,000 lindje të gjalla, sipas grupmoshës




Shpjegimi: Numri i aborteve të ndërprera gjatë vitit për 1,000 lindje të gjalla, të raportuara nga institucionet shëndetësore
Burimi: Instituti i Shëndetit Publik / Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile / INSTAT

Vdekshmëria e fëmijëve, sipas grupmoshës



Shpjegimi: Numri i vdekjeve të fëmijëve nën 28 ditë jetë, nën moshën 1 vjeçare dhe atyre nën moshën 5 vjeçare në një vit të caktuar, për 1,000 lindje të gjalla në të njëjtin vit
Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale / INSTAT


Vdekshmëria amtare



Shpjegimi: Numri i vdekjeve të grave shtatzënë ose grave deri në 42 ditë pas lindjes përmbi numrin e lindjeve të gjalla x 100,000, gjatë të njëjtit vit
Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale / INSTAT


Arsimi

Raporti bruto i regjistrimeve, sipas ciklit arsimor




Shpjegimi: Regjistrimi i fëmijëve në kopësht, 9-vjeçare dhe arsimin e mesëm, shprehur në përqindje krahasuar me popullsinë e grupmoshës teorike që i korespondon këtij niveli të arsimit
Burimi: Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit / INSTAT

Raporti neto i regjistrimeve, sipas ciklit arsimor




Shpjegimi: Regjistrimi i fëmijëve sipas grupmoshës teorike në kopësht, 9-vjeçare dhe arsimin e mesëm, shprehur në përqindje krahasuar me popullsinë e grupmoshës teorike që i korespondon këtij niveli të arsimit
Burimi: Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit / INSTAT


Nxënës të regjistruar për 1,000 banorë



Përqindja e nxënësve që përsëritin vitin akademik




Raporti bruto i diplomimit




Drejtësia

Raporti i fëmijëve të dëmtuar nga veprat penale për 100,000 fëmijë




Përqindja e fëmijëve viktimë të veprave penale




Shpjegimi: Përqindja e fëmijëve (0-17 vjeç) të dëmtuar nga veprat penale të regjistruar në polici gjatë vitit ndaj totalit të personave të dëmtuar
Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë / INSTAT

Raporti i fëmijëve të dyshuar për vepra penale për 100,000 fëmijë, sipas grupmoshës




Shpjegimi: Numri i fëmijëve (0-17 vjeç) të dyshuar për vepra penale, të regjistruar në polici gjatë vitit, në raport me popullsinë respektive
Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë / INSTAT

Përqindja e fëmijëve të dyshuar për vepra penale



Shpjegimi: Përqindja e fëmijëve (14-17 vjeç) të dyshuar për vepra penale ndaj totalit të personave të dyshuar
Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë / INSTAT

Raporti i fëmijëve në institucionet e privimit të lirise për 100,000 popullatë respektive



Shpjegimi: Numri i fëmijëve (14-17 vjeç) në paraburgim dhe të dënuar me burgim në fund të vitit, në raport me 100,000 popullatë mesatare respektive
Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve / INSTAT

Punësimi

Shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës, sipas gjinisë

	2016			2017			2018		
	Mashkull	Femër	Total	Mashkull	Femër	Total	Mashkull	Femër	Total
15 – 17 vjeç									
LFPR*	7.4	4.1	5.9	8.0	4.8	6.6	11.0	6.6	8.9
ER*	5.4	3.6	4.6	4.7	3.3	4.1	6.0	5.4	5.7
15 – 19 vjeç									
LFPR*	16.1	9.5	13.1	16.1	9.5	13.1	18.6	9.9	14.5
ER*	9.9	6.3	8.2	9.9	6.3	8.2	11.8	8.0	10.0
15 – 24 vjeç									
LF*	88165	53485	141650						
LFPR*	36.9	25.8	31.8	37.8	24.5	31.8	43.4	27.6	35.8
ER*	23.1	16.8	20.2	24.9	17.7	21.6	30.6	20.4	25.7

Shpjegimi: Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune
Burimi: Anketa e forcës së punës / INSTAT

LFPR Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës
ER Shkalla e punësimit
LF Forca e punës

Shkalla e punësimit, sipas sektorit

	2016			2017			2018		
	15 – 17	15 – 19	15 – 24	15 – 17	15 – 19	15 – 24	15 – 17	15 – 19	15 – 24
Agrikulturë	75.3	63	37.6	81.5	63	33	81.9	66.1	40.5
Industri	5.3	10.7	13.6	4.4	10.7	15.4	6.3	8.5	11.8
Ndërtim	3.7	3.2	6.7	1.7	3.2	5.2	0.1	2.3	4.4
Shërbime	15.7	23.1	42.1	12.3	23.1	46.4	11.7	23.1	43.3

Shpjegimi: Të punësuar janë konsideruar personat që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës
Burimi: Anketa e forcës së punës / INSTAT



2. Tregues të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

OZHQ 1 - PA VARFËRI	BURIMI	VITI	TË DHËNAT
1.2.1 (1) Përqindja e fëmijëve (0-17 vjeç) në rrezik për të qënë të varfër, bazuar në kufirin kombëtar të rrezikut për të qënë i varfër <i>Meshkuj 28.7; Femra 30.6</i>	Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës / INSTAT	2018	29.6
1.2.1 (2) Përqindja e individëve, anëtarë të familjeve me fëmijë në varësi, në rrezik për të qënë të varfër	Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës / INSTAT	2018	27
1.2.2 (1) Përqindja e fëmijëve, që jetojnë në të gjitha dimensionet e varfërisë, sipas përcaktimeve kombëtare të varfërisë			I pamatur
1.3.1 Përqindja e popullsisë të mbuluar nga sisteme/tavane të mbrojtjes sociale			I pamatur
1.4.1 (1) Raporti i familjeve me fëmijë që jetojnë në banesa me akses të shërbimeve bazë			I pamatur
1.a.2 (1) Përqindja e shpenzimeve totale të buxhetit për arsimin para-universitar	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	2018	10.9
1.a.2 (2) Përqindja e shpenzimeve totale të buxhetit për shërbimet shëndetësore	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	2018	10.3
1.a.2 (3) Përqindja e shpenzimeve totale të buxhetit për mbrojtje sociale			I pamatur

OZHQ 2 - ZERO URI	BURIMI	VITI	TË DHËNAT
2.2.1 Prevalenca e mungesës së zhvillimit tek fëmijët nën 5 vjeç <i>Meshkuj 11.6; Femra 11</i>	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri / INSTAT & Instituti i Shëndetit Publik	2018	11.3
2.2.2 (1) Prevalenca e kequshqyerjes tek fëmijët nën 5 vjeç (nënveshë) <i>Meshkuj 1.2; Femra 2</i>	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri / INSTAT & Instituti i Shëndetit Publik	2018	1.6
2.2.2 (2) Prevalenca e kequshqyerjes tek fëmijët nën 5 vjeç (mbipeshë) <i>Meshkuj 17.4; Femra 15.4</i>	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri / INSTAT & Instituti i Shëndetit Publik	2018	16.4

OZHQ 3 - SHËNDET I MIRË DHE MIRËQËNIE	BURIMI	VITI	TË DHËNAT
3.1.1 Niveli i vdekshmërisë amtare (për 100,000 lindje të gjalla)	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale / INSTAT	2018	3.4
3.1.2 Përqindja e lindjeve të kryera me ndihmën e punonjësve të kualifikuar	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale / INSTAT	2018	99.97

3.2.1	Niveli i vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç (për 1,000 lindje të gjalla) <i>Meshkuj 11; Femra 9</i>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale / INSTAT	2018	10.1
3.2.2	Niveli i vdekshmërisë neonatale (për 1,000 lindje të gjalla) <i>Vlera Absolute: Total 211; Meshkuj 120; Femra 91</i>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale / INSTAT	2018	7.3
3.3.1 (1)	Numri i fëmijëve (0-5 vjeç) të infektuar me HIV për 1,000 popullatë (respektive) të painfektuar <i>Vlera absolute 31</i>	Instituti i Shëndetit Publik / INSTAT	2018	0.16
3.3.1 (2)	Numri i individëve (15-24 vjeç) të infektuar me HIV për 1,000 popullatë (respektive) të painfektuar <i>Vlera absolute 108</i>	Instituti i Shëndetit Publik / INSTAT	2018	0.16
3.3.2 (1)	Incidenca e tuberkulozit për 100,000 popullatë deri 19 vjeç <i>Vlera absolute 31</i>	Instituti i Shëndetit Publik	2018	4.3
3.3.2 (2)	Incidenca e tuberkulozit për 100,000 popullatë 10-24 vjeç <i>Vlera absolute 85</i>	Instituti i Shëndetit Publik	2018	13.2
3.3.4 (1)	Incidenca e Hepatitit B për 100,000 popullatë deri 19 vjeç <i>Vlera absolute 2</i>	Instituti i Shëndetit Publik	2018	0.28
3.3.4 (2)	Incidenca e Hepatitit B për 100,000 popullatë 10-24 vjeç <i>Vlera absolute 4</i>	Instituti i Shëndetit Publik	2018	0.63
3.4.2 (1)	Vdekjet e të rinjve (10-24 vjeç) për shkak të vetëvrasjes për 100,000 popullatë të moshës respektive	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile / INSTAT	2018	6.03
3.5.2 (1)	Përdorimi i alkoolit nga të rinjtë (15 - 24 vjeç)			I pamatur
3.6.1 (1)	Vdekjet nga aksidentet rrugore - viktimat fëmijët dhe të rinjtë			I pamatur
3.7.2 (2)	Niveli i lindjeve në adoleshencë (10-19 vjeç) për 1,000 femra të së njëjtës grupmoshë	Instituti i Shëndetit Publik / INSTAT		14.5
3.8.1	Mbulimi i popullsisë me shërbime bazike shëndetësore			I pamatur
3.9.1	Vdekshmëria për shkak të ajrit të ndotur të ambientit ose të shtëpisë			I pamatur
3.a.1 (1)	Prelevanca e përdorimit të duhanit nga të rinjtë (15 - 24 vjeç)			I pamatur
3.b.1 (1)	Përqindja e popullsisë së synuar e mbuluar nga dozat e vaksinave në lindje	Instituti i Shëndetit Publik	2018	99.1
3.b.1 (2)	Përqindja e popullsisë së synuar e mbuluar nga doza e parë Fruth-Rubeole-Parotit (FRP)	Instituti i Shëndetit Publik	2018	94.1
3.b.1 (3)	Përqindja e popullsisë së synuar e mbuluar nga vakcina Poliomeliti	Instituti i Shëndetit Publik	2018	98.7
3.b.1 (4)	Përqindja e popullsisë së synuar e mbuluar nga vakcina Difteritit, Tetanozit dhe Kollës së mirë (DTP3)	Instituti i Shëndetit Publik	2018	98.8

OZHQ 4 - EDUKIM CILËSOR		BURIMI	VITI	TË DHËNAT
4.1.1 (1)	Përqindja e fëmijëve në fund të arsimit të mesëm të ulët të paktën me një nivel minimal të aftësisë në lexim	PISA / OECD	2018	48
4.1.2 (2)	Përqindja e fëmijëve në fund të arsimit të mesëm të ulët të paktën me një nivel minimal të aftësisë në matematikë	PISA / OECD	2018	58

4.2.1 (1)	Përqindja e fëmijëve (36-59 muajsh) me zhvillimin e duhur shëndetësor, mësimor dhe psiko-social			I pamatur
4.2.2	Shkalla e pjesëmarrjes në të mësuarin e organizuar (një vit para moshës zyrtare të hyrjes në fillore; 5-6 vjeç) -GER	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë / INSTAT	2018	82
4.3.1	Raporti i pjesëmarrjes së të rinjve (15-24 vjeç) në trajnime formale dhe jo formale në 4 javët e fundit <i>Meshkuj 46.8; Femra 55</i>	Anketa e Forcës së Punës / INSTAT	2018	50.8
4.4.1	Përqindja e popullsisë 16-24 vjeç me të paktën një aftësi të përdorimit të Teknologjisë së Informacionit & Komunikacionit (TIK)	Anketimi i Përdorimit të TIK / INSTAT	2018	54.2
4.5.1 (1)	Treguesi i barazisë gjinore për pjesëmarrjen në arsim e ulët	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë / INSTAT	2018	0.95
4.5.1 (2)	Treguesi i barazisë gjinore për pjesëmarrjen në arsimin e mesëm të ulët	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë / INSTAT	2018	0.95

OZHQ 5 - BARAZI GJINORE		BURIMI	VITI	TË DHËNAT
5.2.1 (1)	Përqindja e femrave (18-24 vjeç), që kanë përjetuar dhunë psikologjike nga një partner intim i tanishëm ose i kaluar në 12 muajt e fundit	Anketa Dhuna kundër Grave dhe Vajzave në Shqipëri / INSTAT	2018	38.7
5.2.1 (2)	Përqindja e femrave (18-24 vjeç), që kanë përjetuar dhunë fizike nga një partner intim i tanishëm ose i kaluar në 12 muajt e fundit	Anketa Dhuna kundër Grave dhe Vajzave në Shqipëri / INSTAT	2018	14.6
5.2.1 (3)	Përqindja e femrave (18-24 vjeç), që kanë përjetuar dhunë seksuale nga një partner intim i tanishëm ose i kaluar në 12 muajt e fundit	Anketa Dhuna kundër Grave dhe Vajzave në Shqipëri / INSTAT	2018	14.4
5.2.2 (1)	Përqindja e femrave dhe vajzave (15-19 vjeç), që kanë përjetuar dhunë seksuale nga persona, të cilët nuk janë partnerët e tyre intimë në 12 muajt e fundit	Anketa Dhuna kundër Grave dhe Vajzave në Shqipëri / INSTAT	2018	0
5.3.1 (1)	Përqindja e femrave (20-24 vjeç), që janë martuar ose bashkëjetojnë që përpara moshës 15-vjeçare	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri / INSTAT & Instituti i Shëndetit Publik	2018	1.4
5.3.1 (2)	Përqindja e femrave (20-24 vjeç), që janë martuar ose bashkëjetojnë që përpara moshës 18-vjeçare	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri / INSTAT & Instituti i Shëndetit Publik	2018	11.8
5.4.1 (1)	Raporti (%) i kohës së kaluar nga fëmijët (10 - 14 vjeç) në punë shtëpie dhe përkujdesje <i>Meshkuj 1.8; Femra 8.5</i>	Anketa e Përdorimit të Kohës në Shqipëri / INSTAT	2011	3.7

OZHQ 6 - UJË I PASTËR DHE KANALIZIME		BURIMI	VITI	TË DHËNAT
6.1.1	Përqindja e familjeve me fëmijë (0 - 17 vjeç), që përdorin shërbimet e ujit të pijshëm të menaxhuara në mënyrë të sigurt	Anketa e Buxhetit të Familjes / INSTAT	2018	90.5
6.2.1 (1)	Përqindja e familjeve me fëmijë (0 - 17 vjeç), që përdorin shërbime sanitare të menaxhuara në mënyrë të sigurt, përfshirë larjen e duarve me sapun dhe ujë	Anketa e Buxhetit të Familjes / INSTAT	2018	93.4

OZHQ 7 - ENERGJI E PËRBALLUESHME DHE E PASTËR		BURIMI	VITI	TË DHËNAT
7.1.2	Përqindja e familjeve me fëmijë, që mbështeten në burime kryesore në lëndë djegëse të pastra dhe teknologjike	Anketa e Buxhetit të Familjes / INSTAT	2018	34.6

OZHQ 8 - PUNË DINJITOZE DHE RITJE EKONOMIKE		BURIMI	VITI	TË DHËNAT
8.5.2 (I)	Përqindja e papunësisë (15-24 vjeç) <i>Meshkuj 29.6; Femra 26</i>	Anketa e Forcës së Punës / INSTAT	2018	28.3
8.6.1	Raporti (%) i të rinjve (15 - 24 vjeç) jo në punësim, jo në trainim dhe as duke ndjekur shkollën <i>Meshkuj 25.4; Femra 27.6</i>	Anketa e Forcës së Punës / INSTAT	2018	26.5
8.7.1	Përqindja e fëmijëve (5-17 vjeç) që punojnë në aktivitete ekonomike dhe punë shtëpie <i>Meshkuj 3.6; Femra 3</i>	Anketa e Punës së Fëmijëve në Shqipëri / INSTAT & ILO	2010	3.3

OZHQ 10 - ZVOGËLIMI I PABARAZIVE		BURIMI	VITI	TË DHËNAT
10.2.1 (I)	Përqindja e fëmijëve (0-17 vjeç) që jetojnë nën 50% të medianës së të ardhurave disponibël të ekuivalentuara	Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës / INSTAT	2018	22.1

OZHQ 16 - PAQE DHE DREJTËSI, INSTITUCIONE TË FORTA		BURIMI	VITI	TË DHËNAT
16.1.1 (I)	Norma e fëmijëve (0-17 vjeç) viktimë të vrasjes me dashje (për 100,000 popullatë fëmijë) <i>Vlera absolute 7</i>	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë / INSTAT	2018	1.1
16.1.3 (I)	Përqindja e fëmijëve (0-17 vjeç) subjekte të dhunës fizike, psikologjike ose seksuale në 12 muajt e fundit			I pa raportuar
16.2.1 (I)	Përqindja e fëmijëve (1-14 vjeç), të cilët kanë përjetuar ndëshkim fizik dhe/ose dhunë psikologjike nga kujdestarët e tyre në muajt e fundit	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri / INSTAT&Instituti i Shëndetit Publik	2018	47.5
16.2.2 (I)	Raporti i fëmijëve (0-17 vjeç) viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore (për 100,000 popullatë fëmijë) <i>Vlera absolute 67</i>	Ministria e Brendshme / INSTAT	2018	10.8
16.2.3 (I)	Përqindja e popullsisë (18-29 vjeç), që kanë përjetuar dhunë seksuale para moshës 18-vjeçare			I pamatur
16.3.2 (I)	Fëmijë (14-17 vjeç) në paraburgim si përqindje e popullsisë së moshës respektive në institucionet e privimit të lirisë në 31 Dhjetor <i>Vlera absolute 19</i>	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve / INSTAT	2018	90.5
16.3.2 (2)	Të rinj (14-24 vjeç) në paraburgim si përqindje e popullsisë së moshës respektive në institucionet e privimit të lirisë në fund të vitit <i>Vlera absolute 572</i>	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve / INSTAT		52.5
16.9.1	Përqindja e fëmijëve (nën 5 vjeç), të cilët janë regjistruar në autoritetin civil	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri / INSTAT & Instituti i Shëndetit Publik	2011	98.4



SHTOJCA

Popullsia

Femijë (0-17 vjeç) sipas qarqeve dhe sipas gjinisë

Qarku	2018		
	Meshkuj	Femra	Total
Berat	14,396	13,731	28,128
Dibër	15,916	14,612	30,527
Durrës	32,576	30,715	63,291
Elbasan	32,523	31,175	63,698
Fier	33,853	31,985	65,838
Gjirokastrë	6,746	6,335	13,081
Korçë	24,375	22,578	46,953
Kukës	10,233	9,420	19,653
Lezhë	14,630	14,126	28,756
Shkodër	23,156	22,265	45,421
Tiranë	96,400	91,044	187,444
Vlorë	19,914	18,456	38,370
	324,717	306,443	631,160

Struktura e popullatës fëmijë

Grupmosha	2018		
	Meshkuj	Femra	Total
0-1	32,174	29,829	62,003
0-2	48,419	45,321	93,740
0-3	66,080	62,221	128,301
0-4	83,526	78,890	162,416
0-6	116,721	110,809	227,530
0-14	261,344	245,606	506,950
0-19	369,964	351,622	721,586
3-5	52,074	49,864	101,938
5-9	84,180	79,695	163,875
6-17	224,224	211,256	435,480
14-17	83,445	79,542	162,987
15-19	108,620	106,016	214,636
Popullsia totale në 1 Janar	1,438,609	1,431,715	2,870,324

Burimi: INSTAT

Shëndetësia

Numri i aborteve me ndërprerje, sipas grupmoshës

Mosha	2016	2017	2018
15 - 19 vjeç	31	36	28
20 - 24 vjeç	140	145	147
25 - 29 vjeç	211	243	222
30 - 34 vjeç	200	241	230
35 - 39 vjeç	199	212	191
40 - 44 vjeç	87	96	112
45 - 49 vjeç	13	23	12

Arsimi

Raporti bruto i regjistrimeve, sipas ciklit arsimor dhe gjinisë

	2016		2017		2018	
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Kopshte	81.3	81.8	78.9	81.6	76.3	80.3
9-vjeçare Cikli i ulët fillore	102.8	105	102.3	105.2	99.9	104.8
9-vjeçare Cikli i lartë	95.4	97.9	95.9	98.9	94.2	98.7
Arsim i mesëm	91.1	98	90.1	97.4	91.7	99.3

Raporti neto i regjistrimeve, sipas ciklit arsimor dhe gjinisë

	2016		2017		2018	
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Kopshte	77.6	77.7	75.1	77.4	70.1	73.6
9-vjeçare Cikli i ulët fillore	97	97.9	96.2	97.5	94.1	97.5
9-vjeçare Cikli i lartë	86.6	87.1	88	88.6	86.5	88.8
Arsim i mesëm	78	76.4	77.1	76.4	77.5	77.4

Përqindja e nxënësve që përsëritin vitin akademik, sipas gjinisë dhe ciklit arsimor

	2016		2017	
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
9-vjeçare Cikli i ulët fillore	0.8	1.1	0.7	1
9-vjeçare Cikli i lartë	0.9	1.8	0.7	1.3

Drejtësia

Fëmijë (numër) në kontakt me ligjin

		2016	2017	2018
Fëmijë të dëmtuar nga veprat penale		1,301	1,340	1,248
Fëmijë të dyshuar për kryerjen e veprave penale	Nën 14 vjeç	263	313	292
	14 - 17 vjeç	1,719	1,740	1,299
Fëmijë të dënuar me burgim në institucionet e privimit të lirisë		15	7	2
Fëmijë në paraburgim		43	32	19

Tabela 1

Përqindja e familjeve me fëmijë të grupmoshës 0-15 vjeç të cilat nuk kanë mundësi financiare për të plotësuar secilën nga nevojat e mëposhtme:	2018
Të kenë të paktën një veshje të re (jo në tregun e të përdorurave);	17.5
Të kenë dy palë këpucë/sandale në masën e përshtatshme (përfshirë një palë që përdoret dhe në mot të keq);	7.4
Të ushqehen me fruta/perime të freskëta, të gatuar ose jo, të paktën një herë në ditë;	31.7
Të ushqehen të paktën një vakt në ditë me përmbajtje proteinike (mish / pule / peshk / vezë / fasule / thjerrëza);	39.9
Të kenë në shtëpi libra jashtë shkollor të përshtatshëm për moshën e tyre;	21.1
Të kenë pajisje të përshtatshme për sport dhe aktivitete në natyrë (psh: biçikletë, patina, raketë, etj.);	30.8
Të kenë lodra të përshtatshme për moshën e tyre për të luajtur në shtëpi (lodra për fëmijë të vegjël, lodra ndërtuese, lodra kompjuterike, etj.);	18.1
Të marrin pjesë rregullisht në aktivitete argetuese / sportive jashtë shtëpisë për një periudhë kohe të caktuar gjatë vitit (noti, instrument muzikor, futboli etj.);	40.8
Të festohen ditët e veçanta të fëmijës, si p.sh ditëlindja, dita e emrit;	22.7
Të kenë mundësi të ftojnë një shok/shoqe në shtëpi/ jashtë për të luajtur dhe për të ngrënë diçka;	28.1
Të shkojnë për pushime jashtë shtëpisë të paktën një javë në vit duke përfshirë qëndrimin me shokë/ të afërm.	54.4

Tabela 2

Përqindja e familjeve me fëmijë të grupmoshës 0-15 vjeç të cilët janë duke ndjekur shkollën dhe që nuk kanë mundësi financiare për të plotësuar secilën nga nevojat e mëposhtme:	2018
Të kenë një vend/ hapsirë të përshtatshme në shtëpi për të bërë detyrat / studiuar;	28.0
Të kenë mundësi të shkojnë në ekskursione / evente shkollore edhe nëse u duhet të paguajnë ekstra;	39.3

Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të jetesës / INSTAT - viti 2018

